

1029 11.10.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

3893
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 11/10.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti I Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.101

Datë: 03.10.2023

**“Për përcaktimin si Agjent Tatimor shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër
S.H.A për taksat dhe tarifat për kategorinë familjarë”.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari I Këshillit Bashkiak

Afrim Mikli





3893/
13/10/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1029/1 prot.

Peshkopi, më 12.10.2023

Lënda : Për vendimin nr.101, datë 03.10.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR


Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.101, datë 03.10.2023 "Për përcaktimin si Agjent Tatimor shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër S.H.A për taksat dhe tarifat për kategorinë familjarë", vendosa :

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual, për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje, veprim që kurdoherë është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturës së posaçme të Bashkisë Dibër, që paraqet për miratim projekt akte të kësaj natyre.

Hyrja në fuqi e akteve administrative të kësaj natyre, bëhet sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 101 Datë 03 / 10 / 2023

“Për përcaktimin si Agjent Tatimor shoqërinë rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Dibër SH.A për taksat dhe tarifave për kategorinë familjarë”

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.1/b, si dhe neni 64 “Kompetencat dhe Detyrat e Kryetarit të Bashkisë” ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.687/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr. 108 datë 06.12.2023 “Për miratimin e Paketës Fiskale, Taksave e Tarifave Vendore për vitin 2023”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **03.10.2023** me 20 vota pro, 6 kundër dhe 4 apstenim:

VENDOSI:

- I. Miratimin si agjent tatimor Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A për taksat dhe tarifave për kategorinë familjarë.
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Taksave e Tarifave Vendore të Bashkisë Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.
- IV. Vendimi u shpall me datë **03.10.2023**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak
Irimi Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 02 datë 29/09/2023

**“ PËR PËRCAKTIMIN SI AGJENT TATIMOR SHOQËRINË RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DIBËR SH.A PËR TAKSAT DHE TARIFAT PËR
KATEGORINË FAMILJARË ”**

Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij të datës ___/___/2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Dibër, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.1/b, si dhe neni 64 “Kompetencat dhe Detyrat e Kryetarit të Bashkisë” ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proçedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.687/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr. 108 datë 06.12.2023 “Për miratimin e Paketës Fiskale, Taksave e Tarifave Vendore për vitin 2023”:

Kërkojmë:

- I.** Miratimin si agjent tatimor Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër SH.A për taksat dhe tarifat për kategorinë familjarë.
- II.** Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Taksave e Tarifave Vendore të Bashkisë Dibër.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjës Taksave dhe Tarifave Vendore

Bujar Manja

Drejtor Taksave dhe Tarifave Vendore

Lorenc Cibaku

Drejtor Sektorit Juridik

Ismet Saraçi

KRYETARI I BASHKISË

Rahim Spahiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

RELACION

Baza në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, "Për Taksat Kombëtare", si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.108 datë 06.12.2022 "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023 të Bashkisë Dibër" dhe në Raportin Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Dibër në bazë të Programit të Auditimit nr. 371/1 Prot. datë 08.04.2022 mbajtur në datë 15.04.2022 dhe rekomandimeve të lëna po ju paraqesim këtë projekt vendim për miratim për këtë marrëveshje ndërmjet Bashkisë Dibër dhe Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A, e cila konsiston në vendosjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve lidhur me arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore per kategorinë familjarë. Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Dibër Sh.A, nuk është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit.

Duke qenë para këtij fakti, Bashkia Dibër është e detyruar që ta sjellë në Këshill Bashkiak për miratim këtë marrëveshje midis dy institucioneve, duke vendosur qëllimet dhe kushtet e kësaj kontrate, si dhe duke qenë e vetmja bashki në qark e cila nuk kemi një akt marrëveshje me ujësjetllësin për mbledhjen e taksave dhe tarifave familjare. Qëllimi i marrëveshjes është realizimi i mbledhjes së tarifave dhe taksave, kategoria familjarë të Bashkisë Dibër nëpërmjet shërbimit si agjent tatimor të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A duke përcaktuar mënyrën e mbledhjes së këtyre taksave nëpërmjet faturës së ujit përcaktuar kjo në Vendimin Këshillit Bashkiak Dibër nr.108 datë 06.12.2022 "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023 të Bashkisë Dibër". Midis të dy palëve lindin detyrime të cilat janë të parashkruara edhe në akt-marrëveshjen e firmosur midis palëve.

Detyrimet e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A

- a. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A do të përfshijë në faturën e ujit të pijshëm edhe taksat dhe tarifatat bashkiake për kategorinë familjarë të tilla si tarifa e pastrimit, tarifa e ndricimit dhe taksë pasurie e ndërtesë.
- b. Detyrimi për vitin 2023 do të shpërmdahet për 3 muaj respektivisht (Tetor-Dhjetor) ndërsa për vitin 2024 e në vazhdim do të jetë e shpërndarë në 12 muaj.
- c. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A ka detyrimin që të bashkëpunojë me sektorin e taksave në bashkinë Dibër në mënyrë që të ardhurat e mbledhura për këtë qëllim të derdhen në llogarinë e institucionit brenda 3 ditëve të punës nga data e akt-rakordimit të përbashkët. Akt-rakordimi do të mbahet me përfaqësues të dy palëve brenda datës 05 të çdo muaji pasardhës.
- d. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A është e detyruar të vërë në dispozicion bashkisë Dibër kopje të faturave të ujësjetllës nëse ka dyshime për shumatat e mbledhura ose nëse shikohet që ka shmangie për zbatimin e kësaj marrëveshje.
- e. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A është e detyruar të bashkëpunojë me bashkinë Dibër për miratimin e një modeli fature dhe përdorimin e të dhënave të përbashkëta të kategorisë familjarë.


Detyrimet e Bashkisë Dibër

- a. Bashkia Dibër është e detyruar të dorëzojë ndërmarrjes së Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A listën e familjeve që duhet të mbledhen detyrimet për tarifatat dhe taksat vendore, kategoria familjarë si dhe masën përkatëse të përcaktuar në Vendimin Këshillit Bashkiak Dibër nr.108 datë ~~06.12.2022: "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023 të Bashkisë Dibër"~~
- b. Për 3-mujorin e fundit të vitit 2023 sektori i taksave në bashki duhet të dorëzojë me shkresë Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A një listë me abonentët që kanë paguar këto detyrime.
- c. Bashkia Dibër duhet të njoftojë Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A në rast të ndryshimit të detyrimeve të tilla si vlera, njësi të reja (njësi administrative, fshatra) që iu ofrohet shërbim dhe/ose përjashtime të ndryshme të kategorive nga detyrimi.
- d. Bashkia Dibër është e detyruar të bëjë pagesën për ofrimin e shërbimit në llogarinë e Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A brenda 5 ditëve të punës nga marrja në dorëzim të akt-rakordimit mujor të mbajtur e të dakortësuar mes palëve.
- e. Aplikimi do të zbatohet në të gjithë territorin e bashkisë Dibër aty ku ndërmarrja e ujësjetllës – kanalizime Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A ofron shërbim duke respektuar rregullin që tarifatat nuk do të aplikohen në njësitë administrative / fshatrat që nuk iu ofrohet shërbimi që ka lidhje me tarifën (pastrimi dhe ndricimi).

Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj marrëveshjeje nga data e nënshkrimit të saj dhe është me afat të papërcaktuar. Në rast të problemeve gjatë zbatimit të marrëveshjes, palët marrin përsipër të komunikojnë midis tyre për zgjidhjen me mirëkuptim të të gjitha mosmarrëveshjeve. Në rast të problemeve në zbatimin e kësaj marrëveshjeje kur nuk është mundur zgjidhja me mirëkuptim, palët duhet të drejtohen gjykatës administrative të shkallës së parë. Çdo ndryshim të akteve ligjore e nënligjore, për aq sa ato lidhën me këtë marrëveshje do të reflektohen zyrtarisht në ndryshimin e saj. Kjo marrëveshje përfundon vetëm në rast të ndryshimit të formës së mbledhjes së tarifave ose taksave lokale nga këshilli bashkiak Diber ose të ndonjë baze ligjore që prek aspekte të kësaj marrëveshjeje.

Përgjegjës Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore


Bujar Manja



Drejtor Taksave dhe Tarifave Vendore

Lorenc Cibaku





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KRYETARI I BASHKISË

3773

Nr. ... prot.

Peshkopi, më 09/10 .2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Bashkia Dibër, përfaqësuar nga z.Rahim Spahiu, Kryetari i Bashkisë, lidh sot këtë marrëveshje bashkëpunimi me termat e mëposhtme me Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A përfaqësuar nga z. Mario Bakalli administrator i saj. Palët deklarojne që me vullnetin e tyre të lire dhe të plote në përputhje me kompetencat që iu ka dhënë ligji bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekt i marrëveshjes


Objekt i kësaj marrëveshje ndërmjet Bashkisë Dibër dhe Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A konsiston në vendosjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve lidhur me arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifët vendore per kategorinë familjare.

Neni 2

Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj marrëveshje është ligji nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.9920 datë 30.10.2006 "Për sistemimin e taksave vendore" i ndryshuar, të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", VKM nr.319 datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve" si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.108 datë 06.12.2022 "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023 të Bashkisë Dibër".

Adresa: Bulevardi "El Enxhuf", Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com nr.tel:0035521822935





Neni 3

Qëllimi i Marrëveshjes

Realizimi i mbledhjes së tarifave dhe taksave, kategoria familjarë të Bashkisë Dibër nëpërmjet shërbimit si agjent tatimor të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A duke përcaktuar mënyrën e mbledhjes së këtyre taksave nëpërmjet faturës së ujit përcaktuar kjo në Vendimin Këshillit Bashkiak Dibër nr.108 datë 06.12.2022 "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023 të Bashkisë Dibër".

Neni 4

Detyrimet e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A



1. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A do të përfshijë në faturën e ujit të pijshëm edhe taksat dhe tarifat bashkiake për kategorinë familjarë të tilla si tarifa e pastrimit, tarifa e ndricimit dhe taksë pasurie e ndërtese.
2. Detyrimi për vitin 2023 do të shpërndalet për 3 muaj respektivisht (Tetor-Dhjetor) ndërsa për vitin 2024 e në vazhdim do të jetë e shpërndarë në 12 muaj.
3. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A ka detyrimin që të bashkëpunojë me sektorin e taksave në bashkinë Dibër në mënyrë që të ardhurat e mbledhura për këtë qëllim të derdhen në llogarinë e institucionit brenda 3 ditëve të punës nga data e akt-rakordimit të përbashkët. Akt-rakordimi do të mbahet me përfaqësues të dy palëve brenda datës 05 të çdo muaji pasardhës.
4. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A është e detyruar ti vërë në dispozicion bashkisë Dibër kopje të faturave të ujësjetllës nëse ka dyshime për shumën e mbledhura ose nëse shikohet që ka shmangie për zbatimin e kësaj marrëveshje.
5. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A është e detyruar të bashkëpunojë me bashkinë Dibër për miratimin e një modeli fature dhe përdorimin e të dhënave të përbashkëta të kategorisë familjarë.

Neni 5

Detyrimet e Bashkisë Dibër

1. Bashkia Dibër është e detyruar ti dorëzojë ndërmarrjes së Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A listën e familjeve që duhet tu mblidhen detyrimet për tarifat dhe taksat vendore, kategoria familjarë si dhe masën përkatëse të përcaktuar në Vendimin Këshillit Bashkiak Dibër nr.108 datë 06.12.2022 "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023 të Bashkisë Dibër".
2. Për 3-mujorin e fundit të vitit 2023 sektori i taksave në bashki duhet ti dorëzojë me shkresë Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A një listë me abonentët që kanë paguar këto detyrime.

Adresa: Bulevardi "ELEZ ISUFT", Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com tel:0035521822935



3. Bashkia Diber duhet të njoftojë Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Diber SH.A në rast të ndryshimit të detyrimeve të tilla si vlera, njësi të reja (njësi administrative, fshatra) që iu ofrohet shërbim dhe/ose përjashtime të ndryshme të kategorive nga detyrimi.

4. Bashkia Diber është e detyruar të bëjë pagesën për ofrimin e shërbimit në llogarinë e Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Diber SH.A brenda 5 ditëve të punës nga marrja në dorëzim të akt-rakordimit mujor të mbajtur e të dakortësuar mes palëve.

5. Aplikimi do të zbatohet në të gjithë territorin e bashkisë Diber aty ku ndërmarrja e ujësjetllës – kanalizime Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Diber SH.A ofron shërbim duke respektuar rregullin që tarifat nuk do të aplikohen në njësitë administrative / fshatrat që nuk iu ofrohet shërbimi që ka lidhje me tarifën (pastrimi dhe ndriçimi).

Neni 6

Aspekti financiar

1. Nuk lejohet pagesa pjesore e faturës që do të thotë: Nuk mund të autorizohet pagesa e detyrimit të ujësjetllësit dhe të anashkalohet detyrimi për taksat dhe tarifat vendore.

2. Në rastin e ankesave të banorëve në lidhje me nivelin e tarifave dhe/ose vlerën e detyrimit Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Diber SH.A duhet të njoftojë menjëherë sektorin e taksave për saktësim të ankesës dhe më pas mund të bëhet likuidimi i faturës.

3. Bashkia Diber do të paguajë Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Diber SH.A në vlerën 5 % të shumës së mbledhur dhe të derdhur në llogarinë e Bashkisë. Pagesa do të bëhet sipas përcaktimit në nenin 5, pika 4.

~~4. Efektet financiare për vitin 2023 për pagesën si arjeut tatimor do të mbulohen nga buxheti i miratuar për këtë vit në artikullin 602, zëri "Shërbime nga të tretët". Për vitin tjetër do të rishikohet përcaktimi i këtij detyrimi varësisht nga shuma dhe ndikimi buxhetor.~~



Neni 7

Zbatimi i marrëveshjes

1. Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj marrëveshjeje nga data e nënshkrimit të saj dhe është me afat të përcaktuar.

2. Në rast të problemeve gjatë zbatimit të marrëveshjes, palët marrin përsipër të komunikojnë midis tyre për zgjidhjen me mirëkuptim të të gjitha mosmarrëveshjeve. Në rast të problemeve në zbatimin

Adresa: Bulevardi "ELEZ SUFFI", Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com nr. tel: 0035521822935



e kësaj marrëveshjeje kur nuk është mundur zgjidhja me mirëkuptim , palët duhet ti drejtohen gjykatës administrative të shkallës së parë.

Cdo ndryshim të akteve ligjore e nënligjore, për aq sa ato lidhën me këtë marrëveshje do të reflektohen zyrtarisht në ndryshimin e saj.

4. Kjo marrëveshje përfundon vetëm në rast të ndryshimit të formës së mbledhjes së tarifave ose taksave lokale nga këshilli bashkiak Dibër dhe / ose të ndonjë baze ligjore që prek aspekte të kësaj marrëveshjeje.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe hartohet në dy kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe nga një kopje për secilën palë.
2. Palët përgjigjen reciprocikisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshjeje.

Për Bashkinë Dibër

Për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër SH.A.

KRYETARI

ADMINISTRATORI

Rahim Spahiu

Mario Bakalli

